

Skenari

Skenari i mëposhtëm shërben për të skicuar situatën fillestare dhe fushat problematike, që përcaktojnë kuadrin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ai përshkruan mjedisin ku lëvizin aktorët, kur është fjala për përcaktimin e kriterëve, afateve dhe rregulloreve të përkohshme për pranimin në BE të shteteve të tjera për të mbërritur në këtë mënyrë në marrjen e një vendimi të përbashkët rreth trajtës së ardhshme të „shtëpisë Evropë“.

Situata reale

Integrimi evropian është që prej fillimeve të veta një proces i hapur, që me kalimin e kohës ka përfshirë gjithnjë e më shumë vende. Që prej momentit të themelimit të Komunitetit Evropian në vitin 1951 ky proces ka kaluar pesë runde zgjerimi. Zgjerimi i fundit i Bashkimit Evropian me Bullgarinë dhe Rumaninë në janar 2007 ka qenë i një rëndësie të veçantë, pasi i dha fund ndarjes dhjetëvjeçare të kontinentit evropian. Që me anëtarësimet historike të Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Çekisë, Hungarisë dhe Qipros në maj të vitit 2004, u bë e mundur të kapërcehej përfundimisht „perdja e hekurt“ që e kishte ndarë Evropën për një kohë të gjatë në lindje dhe perëndim. Shtëpia evropiane numëron tanimë 27 anëtarë me të drejta të plota. Tani janë gjithsej 480 milionë njerëz që me 11,1 bilionë euro përbëjnë një të katërtën e prodhimit social bruto të të gjithë botës.

Skenari

Skenari ynë përqendrohet në tetë vende të tjera kandidate për anëtarësim: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kosova, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia. Në fazën e parë, pas zgjerimeve të viteve 2004 dhe 2007, shtete të reja dhe të vjetra anëtare të BE-së kanë mbledhur përvojat e para në lidhje me shanset dhe problemet e bashkëpunimit brenda BE-së së 27 vendeve. Të gjithë së bashku janë përballur tanimë sërish me vendimin për të pranuar në BE anëtarë të tjerë, pasi të tetë shtetet kanë bërë të ditur, se duan të dorëzojnë një kërkesë anëtarësimi sa më shpejt të jetë e mundur. Prej institucioneve të BE-së kërkohet të reagojnë mbi këtë situatë historike si dhe të marrin vendimet e nevojshme për raundin e ardhshëm të zgjerimit brenda një mjedisi shumë konfliktual. A duhet që BE-ja të pranojë anëtarë të rinj? Nëse po, me cilat kushte? Dhe kur?

Në kontekstin e vendimmarrjeve të tilla të vështira Komisioni Evropian, Këshilli i Ministrave, deputetët e Parlamentit Evropian dhe përfaqësuesit dhe përfaqësueset e vendeve kandidate për anëtarësim takohen sot të gjithë së bashku për të diskutuar rreth modaliteteve të një raundi zgjerimi të mundshëm në të ardhmen. Të gjithë ata duhet të marrin një vendim për të ardhmen e Evropës. Komisioni Evropian, i cili nxit prej kohësh vijimin e procesit të zgjerimit, ka një qëndrim në parim pozitiv përkundrejt hapjes së bisedimeve të anëtarësimit. Parlamenti Evropian do të merret me vendet kandidate në seancat e tij të ardhshme. Por se në ç’rezultat do të mbërrijnë ministrat dhe ministret e jashtëm/e në takimin e tyre të rradhës brenda Këshillit, është ende krejtësisht e hapur.

Në momentin e bisedimeve të anëtarësimit panoramën politike e dominojnë këto komplekse problemesh:

1. Në një kuptim shumë të përgjithshëm diskutimi sillet rreth pyetjes, **ku shtrihen kufinj të përfundimtarë të BE-së** dhe nëse ka kuptim, që komuniteti të vazhdojë të zgjerohet edhe më tej. Në këtë kontekst diskutohen edhe alternativa të tjera të mundshme të zgjerimit. Kjo zgjidhje alternative paraqitet veçanërisht në rastin e Turqisë, pasi disa pjesëmarrës janë të mendimit që Turqia gjeografikisht nuk është pjesë e Evropës dhe

dallon shumë nga Bashkimi Evropian në pikëpamje kulturore, për tu bërë anëtar i tij me të drejta të plota. Këtij argumenti pala tjetër i kundërpërgjigjet duke thënë, që BE-ja nuk është një klub kulturor apo fetar, por një komunitet vlerash që jeton pikërisht në sajë të larmisë së vet.

2. Një potencial tjetër konflikti vërehet në lidhje me çështjen e **financimit të zgjerimit**. Që tani konstatohet një distancë e madhe në mirëqenien mes anëtarëve të vjetër dhe atyre të ardhur së fundmi, veçanërisht Bullgarisë dhe Rumanisë, distancë kjo që BE përpiqet ta eliminojë me ndihma financiare në vlerë miliardash. Disa prej shteteve anëtare aktuale kanë frikë se mos, në rastin e një raundi të ri të zgjerimit, do të humbin privilegje të caktuara financiare. Në tërësi do të nevojiteshin shumë më tepër pará, në mënyrë që si shteteve të vjetra anëtare ashtu edhe atyre të reja e më të varfra t'u garantohej mbështetja e duhur. Por kjo has në kundërshtimin e atyre shteteve anëtare, që kontribuojnë veçanërisht shumë në buxhetin evropian.
3. Diskutime të tjera ka edhe në lidhje me **pasojat e mundshme të zgjerimit mbi ekonominë dhe tregjet e punës së shteteve anëtare aktuale**. Shumë prej këtyre vendeve të prekura të BE-së kanë frikë, që firma të caktuara mund të zhvendosin procesin e prodhimit në shtetet e reja potenciale për anëtarësim, duke qenë se atje pagat dhe kostot e prodhimit janë më të ulëta, dhe, anasjelltas, në kuadër të lëvizjes së lirë të personave, fuqia punëtore e lirë e këtyre shteteve do të vijë për të punuar në vendet anëtare të vjetra të BE-së.
4. Por diskutimi për zgjerimin e BE-së duhet parë edhe në një kontekst më të gjerë ndërkombëtar. Një ndikim të veçantë në hapjen e bisedimeve për anëtarësim kanë para së gjithash dy konflikte ndërkombëtare, duke qenë se këtu janë përfshirë shtete anëtare dhe/ose kandidatë për anëtarësim në BE. Së pari është **konflikti i Qipros**, i cili luan një rol bazë në bisedimet me Turqinë. Që prej vitit 1974 ky ishull është i ndarë faktikisht në dy pjesë: në veriun turko-qipriot, dhe në republikën greko-qipriote në jug, e cila që prej vitit 2004 ka statusin e shtetit anëtar të BE-së, por që nuk njihet nga Turqia. Një referendum i organizuar nga Kombet e Bashkuara në prill 2004 rreth ribashkimit të ishullit ndeshi në refuzimin e popullsisë greko-qipriote në jug të tij.
5. Konflikti i dytë, edhe më i rëndë, që ndikon në bisedimet e anëtarësimit, janë **luftrat civile të viteve nëntëdhjetë në Ballkan**. Këto përplasje të dhunshme mes grupeve të ndryshme etnike, që pasuan shpërbërjen e Republikës së Jugosllavisë, mbartën „spastrime të tmerrshme etnike“ dhe dëbimin e qindra-mijëra njerëzve duke destabilizuar kështu rajonin për një kohë të gjatë. Një anëtarësim i mundshëm i njërit prej tetë shteteve të rajonit në BE mund të kishte një lloj funksioni shembull për shtetet e tjera, dhe konsiderohet si një hap i mëtejshëm i rëndësishëm drejt vendosjes së qëndrueshme të paqes në Ballkan. Në këtë kontekst nuk është përmbyllur ende zbardhja e **krimeve të kryera të luftës**. Bashkëpunimi me gjykatat ndërkombëtare në këtë drejtim ka vend të përmirësohet më tej.
6. **Njohja e Kosovës** si shtet i pavarur ka sjellë trazirë në Bashkimin Evropian. Deri më tani janë ende pesë shtete të Bashkimit Evropian, që nuk e kanë njohur ende Kosovën: Spanja, Greqia, Qiproja, Rumania dhe Sllovakia. Pranimi në BE i një shteti që nuk njihet nga të gjitha shtetet anëtare të tij, është i paimagjinueshëm. BE duhet të gjejë një pozicion të përbashkët në lidhje me Kosovën.
7. Greqia refuzon të njohë **Republikën e Maqedonisë** me emrin e saj kushtetues. Tanimë ka shpërthyer vullshëm debati, nëse BE mund të përcaktojë emrin që një popull kërkon t'i vërë vetes së vet, dhe cilët brenda BE-së mund ta bëjnë këtë. Shtetet e BE-së nuk kanë një mendim të njëjshëm në lidhje me këtë çështje. Nëse një shtet anëtar vendos veton, në BE nuk mund të pranohet asnjë shtet tjetër.

8. Në mbyllje diskutimi mbi zgjerimin vazhdon të jetë një diskutim rreth **BE-së dhe të ashtuquajturit kapacitet pranues të tij**. Sa më shumë anëtarë të bëhen pjesë e vendimmarrjes së përbashkët në institucione, aq më të komplikuar dhe të vështira do të bëhen këto procedura. Për këtë arsye zgjerimet e deritanshme më së shumti janë shoqëruar me reforma në institucionet dhe proceset e vendimmarrjes në BE. Pikëpamje të ndryshme ekzistojnë edhe në lidhje me çështjen, se si do të mundësohet mirëfunksionimi i institucioneve të BE për një numër më të madh shtetesh anëtare.

Institucionet e BE-së dhe mekanizmat vendimmarëse të tij ofrojnë një kuadër në të cilin mund të gjendet balanca e të gjitha këtyre interesave të ndryshme dhe të arrihet kompromisi. Në fund të fundit fjala është që të bihet dakord për strukturimin e ardhshëm gjeografik dhe organizativ të Bashkimit Evropian, gjë që është një avantazh për të gjitha palët. E ardhmja e Evropës ndodhet tani në duart Tuaja. Shumë sukses gjatë bisedimeve!

Simulimi e shkurton në disa orë procesin e zgjerimit, i cili në realitet shtrihet në disa vite.

Informacione dytësore

Bashkimi Evropian konceptohet si një komunitet i hapur, në të cilën mund të bëjë pjesë çdo shtet evropian, që është i gatshëm të ndjekë objektivat e marrëveshjes dhe që mund të përmbushë kritere të caktuara brenda një periudhe kohore të caktuar. Gjatë këtij procesi secili vend vlerësohet më vete. Zbatim gjejnë rregullat si më poshtë:

Nene të rëndësishme të Marrëveshjes

Neni 49 i Marrëveshjes së Bashkimit Evropian

„Çdo shtet evropian, i cili respekton parimet e pëcaktuara në nenin 6, kreu 1 të Marrëveshjes mund të bëjë kërkesën për t'u bërë anëtar i BE-së. Kërkesa i dorëzohet Këshillit i cili pasi ka marrë mendimin e Komisionit dhe miratimin e Parlamentit Evropian – që realizohet me shumicën absolute të deputetëve – duhet të marrë një vendim unanim. Kushtet e pranimit dhe përshtatjet, që rezultojnë të domosdoshme t'u bëhen marrëveshjeve, mbi të cilat mbështetet BE, pasi është vendosur pranimi, rregullohen me marrëveshje midis shteteve anëtar dhe shtetit që ka bërë kërkesën. Kjo marrëveshje më pas duhet të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare në përputhje me dispozitat e tyre kushtetuese.“

Neni 6 (1) i Marrëveshjes për Bashkimin Evropian

„BE mbështetet mbi parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore si dhe mbi shtetin ligjor; këto parime janë të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare.“

Kriteret e Kopenhagenit

Në Samitin e Kopenhagenit të vitit 1993 drejtuesit e shteteve dhe të qeverive të vendeve të BE-së morën vendimin për të konkretizuar më tej kriteret e nenit 49 në lidhje me pranimin e shteteve të reja anëtare. Kushtet, e njohura tashmë me termin Kriteret e Kopenhagenit përcaktojnë, që një shtet i cili dëshiron të bëhet anëtar i BE duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme ekonomike dhe politike:

- Institucione të qëndrueshme si garanci për demokracinë dhe shtetin ligjor, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve
- Një ekonomi tregu funksionale dhe kapaciteti për t'i bërë ballë presionit të konkurrencës dhe të fuqisë së tregut brenda BE-së
- Aftësia për të përmbushur të gjitha detyrimet e një shteti anëtar dhe për të marrë përsipër të gjitha rregullat, standardet dhe politikat, që përbëjnë bazën ligjore të Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*)

M 4. Rregullorja e brendshme

(kryqëzoni)

- e Këshillit të Bashkimit Evropian
- e Komisionit të Parlamentit Evropian
- e Komisionit Evropian

..... ka këtë rregullore të brendshme:

1.

2.

3.

4.

5.

6.

M 7. Pozicionimi i Komisionit Evropian



Komisioni Evropian

Ekspertizë drejtuar Këshillit rreth anëtarësimit të shteteve në Bashkimin Evropian

Komisioni Evropian e konsideron zgjerimin e Bashkimit Evropian si një hap të mëtejshëm drejt plotësimit të atmosferës dhe qëllimit të Traktatit të Romës të vitit 1957.

Në kontekstin e zhvillimeve aktuale mbarëevropiane dhe të unikalitetit të integritetit evropian duhet shfrytëzuar ky shans historik dhe Evropa të formësohet rishtas.

Në Evropën Lindore dhe Juglindore do të ketë stabilizim demokratik dhe ekonomik vetëm nëse vendeve përkatëse do t'u bëhet e ditur një perspektivë e afërt anëtarësimi. Kjo vlen para së gjithash duke patur në koonsideratë shpresat dhe pritshmëritë e popujve të vendeve të rajonit, që në maj 2004 nuk u bënë ende anëtare të BE-së.


Komisioni Evropian gjykon që vënia në diskutim e zgjerimit të Bashkimit Evropian me shtete të Evropës Lindore dhe Juglindore do të sjellë stanjacionin e procesit të integritetit evropian. Në kë mënyrë ka rrezik që progresi i shënuar dekadat e fundit të bëjë hapa të sukshme prapa. Por Komisioni është i vetëdijshëm për problemet dhe sfidat që ka BE-ja në fazën e ardhshme të zgjerimit të vet. Duke e përmbledhur Komisioni Evropian mbështet idenë, që mund të vijohet të ecet në rrugën e zgjerimit të Bashkimit Evropian sipas itinerarit të përcaktuar bashkarisht. Për këtë arsye Komisioni rekomandon që të hapen bisedimet për anëtarësim me vendet e mëposhtme:

-
-
-
-

Kandidatë të tjerë të mundshëm janë:

-
-
-
-
-

M 8. Ftesa e Këshillit të Bashkimit Evropian



Bruksel, më

Këshilli i Bashkimit Evropian

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

kemi kënaqësinë t'ju përshëndesim në cilësinë e përfaqësuesve të vendeve që aspirojnë kandidimin në mbledhjen tonë datë, në orën, salla e mbledhjeve nr.1. Jeni të lutur të përgatisni një prezantim të shkurtër të interesit Tuaj për anëtarësim.

Do të keni mundësinë të prezantoni brenda pesë minutave përparësitë dhe perspektivat e një anëtarësimi të mundshëm të vendit Tuaj. Jeni të lutur të përgatiteni për pyetje kritike.

Në mbyllje do të organizohet një konferencë e shkurtër shtypi me përfaqësues të medias.

Gëzohemi për pjesëmarrjen Tuaj!

M 9. Shënim për shtypin nga Parlamenti Evropian



EUROPA-PARLAMENTET
EUROPAISCHES PARLAMENT
EYPOPAIKO KONGPOYAIQ
EUROPEAN PARLIAMENT
PARLAMENTO EUROPEO
PARLEMENT EUROPEEN
PARLAMENTO EUROPEO
EUROPEES PARLEMENT
PARLAMENTO EUROPEU
EUROOPAN PARLAMENTTI
EUROPAPARLAMENTET

Bruksel, më

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

Ju ftojme përzierisht në seancën tonë të hapur për publikun më në orën në sallën e mbledhjeve plenare. Në mbyllje do të ketë mundësi të bëhen pyetje gjatë një konference të shkurtër për shtyp.

Parlamenti Evropian

M 10. Informacione për shtypin rreth vendeve kandidate

Zyra Shtetërore për Shtypin e

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

më poshtë do të gjeni një informacion të shkurtër në lidhje me stadin aktual të zhvillimeve ekonomike dhe politike në vendin tonë. Shpresoj, që Ju do të informoni në mënyrë sa më objektive rreth vendit tonë në gazetën Tuaj.

Përshëndetje miqësore

M 11. Pozicionimi i Komisionit të Parlamentit Evropian



EUROPA-PARLAMENTET
EUROPÄISCHES PARLAMENT
ΕΥΡΩΠΑΪΚΟ ΚΟΙΝΟΒΟΥΛΙΟ
EUROPEAN PARLIAMENT
PARLAMENTO EUROPEO
PARLEMENT EUROPÉEN
PARLAMENTO EUROPEO
EUROPEES PARLEMENT
PARLAMENTO EUROPEU
EUROOPAN PARLAMENTTI
EUROPAPARLAMENTET

Bruksel, më

Parlamenti Evropian

Komisioni për Punët e Jashtme

Në seancën e datës Komisioni i Parlamentit Evropian për Punët e Jashtme ka diskutuar në mënyrë të hollësishme rreth argumenteve pro dhe kundër një faze të re të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Për seancën plenare të Parlamentit Evropian Komisioni pozicionohet si më poshtë:

Bruksel, më

.....
Kryetari/ja e Komisionit

M 12. Deklaratë e Këshillit të Bashkimit Evropian



Bruksel, më

Këshilli i Bashkimit Evropian

Shumë të nderuar zonja dhe zotërinj,

me anë të kësaj shkrese Komisioni Evropian ngarkohet të hapë bisedimet e anëtarësimit me shtetet

sipas kushteve të mëposhtme:

Komisioni duhet të informojë në mënyrë të vazhdueshme Këshillin dhe Parlamentin Evropian në lidhje me rrjedhën e bisedimeve dhe t'u paraqesë atyre një projekt-marrëveshje të plotë.

Bruksel, më

.....
Kryesia e Këshillit

M 13. Marrëveshje për anëtarësimin në Bashkimin Evropian



Bruksel, më

Komisioni Evropian, Bruksel

Marrëveshje për anëtarësimin në BASHKIMIN EVROPIAN

Përfaqësueset dhe përfaqësuesit e

.....
.....
.....

kanë vendosur, që të pranohet në Bashkimin Evropian.

U ra dakord për plotësimin e kushteve të mëposhtme të anëtarësimit:

§ 1

§ 2

§ 3

§ 4

Bruksel, më

.....
Nënshkrimi i të autorizuarit të
kandidat për anëtarësim

.....
Nënshkrimi i Kryesisë së Këshillit vendit

M 14. Invitation of the European Commission



Bruksel, më

Komisioni Evropian

Ftesë

për në
Konferencën organizuar me rastin e pranimit të shteteve të tjera
në Bashkimin Evropian

datë, ora

në sallën e konferencave

Ftohen të gjithë përfaqësueset dhe përfaqësuesit e Këshillit të Parlamentit Evropian, të deleguarit e vendeve candidate si dhe përfaqësues të shtypit.

Rendi i ditës:

1. Fjala e Kryetares/it të Komisionit
2. Fjalët e përfaqësuesve/eve të Këshillit
3. Fjalët e përfaqësuesve/eve të Parlamentit
4. Fjalët e përfaqësuesve/eve të vendeve candidate
5. Nënshkrimi i Marrëveshjes së anëtarësimit
6. Konferencë e përbashkët për shtyp

M 15. Propozim për ndarjen e roleve

Grupet		E thjeshtë	Dyfish	Minimale	Sehmbull
Parlamenti Evropian	Parti-Vend	22	44	7	12
Fraksioni i EVP	<i>CDU-Gjermani</i>	1	2	1	1
Fraksioni i EVP	<i>CSU-Gjermani</i>	1	2		
Fraksioni i EVP	<i>UMP-Franca</i>	1	2		1
Fraksioni i EVP	<i>Conservatives-Britani e Madhe</i>	1	2	1	1
Fraksioni i EVP	<i>ODS-Republika Ceke</i>	1	2	1	1
Fraksioni i EVP	<i>Forza Italia-Itali</i>	1	2		
Fraksioni i EVP	<i>Partido Popular-Spanjë</i>	1	2		
Fraksioni i SPE	<i>SPD-Gjermani</i>	1	2	1	1
Fraksioni i SPE	<i>SAP-Suedi</i>	1	2		1
Fraksioni i SPE	<i>Labour-Britani e Madhe</i>	1	2		1
Fraksioni i SPE	<i>SPÖ-Austri</i>	1	2		
Fraksioni i SPE	<i>PS-Francë</i>	1	2	1	
Fraksioni i SPE	<i>MLP-Maltë</i>	1	2		
Fraksioni i ALDE	<i>VVD-Hollandë</i>	1	2	1	1
Fraksioni i ALDE	<i>FDP-Gjermani</i>	1	2		
Fraksioni i „Të gjelbërit“	<i>Ecolo-Belgjikë</i>	1	2		1
Fraksioni i „Të gjelbërit“	<i>Les Verts-Francë</i>	1	2	1	
Fraksioni i „Të gjelbërit“	<i>Die Grünen-Austri</i>	1	2		1
Fraksioni i „Të gjelbërit“	<i>Bündnis 90/Die Grünen-Gjermani</i>	1	2		
Fraksioni i GUE/NGL	<i>KKE-Greqi</i>	1	2		1
Fraksioni i GUE/NGL	<i>KSČM-Republika Ceke</i>	1	2		
Fraksioni i UEN	<i>TB/LNNK-Letoni</i>	1	2		1
Këshili i BE		25	50	11	25
Belgjikë		1	2	1	1
Danimarkë		1	2		1
Gjermani		1	2	1	1
Estoni		1	2		1
Finlandë		1	2		1
Francë		1	2	1	1
Greqi		1	2		1
Britani e Madhe		1	2	1	1
Irlandë		1	2		1
Itali		1	2		1
Letoni		1	2	1	1
Lituani		1	2		1

Grupet		E thjeshtë	Dyfish	Minimale	Sehmbull
Luksemburg		1	2		1
Hollandë		1	2		1
Maltë		1	2		1
Austri		1	2		1
Poloni		1	2	1	1
Portugali		1	2		1
Suedi		1	2	1	1
Sllovaki		1	2		1
Slloveni		1	2		1
Spanjë		1	2	1	1
Republika Ceke		1	2	1	1
Hungari		1	2	1	1
Qipro		1	2	1	1
KOMISIONI					
		2	4	1	2
„Vendet kandidate“					
		2	4	2	4
Kroaci		1	2	1	2
Turqi		1	2	1	2
PËRFAQËSUESIT E MEDIAVE					
		8	16	2	6
Gjithsej					
		59	118	23	49

M 16. Propozime për njoftimin e përsheptimit të procedurave

Bruksel – Luksemburg – Strasburg

Gjendje serioze kaotike e qarkullimit në Bruksel

Sikurse sapo u njoftua nga Sindikata belge e transporteve sot në Aeroportin ndërkombëtar të Brukselit dhe në hekurudhat belge do të ketë një grevë të shkurtër në mbarë vendin. Kjo grevë do të fillojë në orën, që do të thotë që prej këtij momenti nuk do të jetë i mundur kthimi në vendet përkatëse.

Ndaj deri në orën duhet të jetë realizuar përfundimisht pranimi i shteteve të tjera në Bashkimin Evropian.

Bruksel – Luksemburg – Strasburg

Arrestohet një aktivist turk për të drejtat e njeriut

Sot në mëngjes është arrestuar në Turqi kryetari i Shoqatës Turke për të drejtat e njeriut. Ky akt tregon për fat të keq, që Turqia, megjithë premtimet e bëra, është ende larg pranimet në BE. Për këtë duhen realizuar fillimisht premtimet e Ankarasë zyrtare për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut.

Në këtë moment kërkohet prej Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian të rimendojnë kursin e tyre përkundëjt Turqisë dhe të reagojnë në mënyrë të pëkuivokueshme në lidhje me këtë provokim të ri.

M 18. Të drejtat dhe kompetencat

Komisioni Evropian

Përbërja dhe detyrat:

- Presidenti dhe 26 komisarë të tjerë
- Përfaqësimi i Komunitetit nga brenda dhe jashtë
- Garantimi i funksionimit dhe zhvillimit të tregut të përbashkët

Mjetet:

- E drejta për të marrë pjesë në konceptimin (e drejta për marrjen e iniativës), zbatimin dhe mbikqyrjen e të drejtës komunitare
- Përfaqësim ndërkombëtar i Bashkimit Evropian

Funksioni dhe të drejtat gjatë simulimit:

- Shoqëron gjithë procesin e zgjerimit
- Përpunon ekspertizat për Këshillin e BE-së në lidhje me mundësitë e anëtarësimit të vendeve kandidatë
- I ngarkuar nga Këshilli drejton bisedimet me vendet kandidatë
- Përpunon propozimin për marrëveshjen e anëtarësimit
- Gjithsesi nuk ka kompetencë vote në lidhje me pranimin përfundimtar

Parlamenti Evropian:

Përbërja dhe detyrat:

- 785 deputetë nga 27 vende anëtare të BE-së.
- Të drejta këshillimi dhe kontrolli, vecanërisht përkundrejt Komisionit
- Të drejta bashkëveprimi në ligjvënien dhe hartimin e buxhetit
- Jep miratimin për marrëveshjet e anëtarësimit dhe të asociimit

Mjetet:

- Këshillim dhe kontroll
- Votë mosbesimi përkundrejt Komisionit Evropian

- Të drejta vendimmarrjeje në procedurat ligjvënëse
- Kompetenca buxhetore
- Zgjedhja e një të ngarkuari/e civil

Funksioni dhe të drejtat gjatë simulimit:

- Këshillim për kërkesat për anëtarësim
- Pozicionim në lidhje me kërkesat për anëtarësim
- E drejtë definitive vendimmarrjeje me shumicën absolute të anëtarëve të vet

Këshilli i Bashkimit Evropian:

Përbërja dhe detyrat:

- Nga një ministër/re për çdo shtet anëtar
- Funksione legjislative dhe ekzekutive

Mjetet:


- Koordinimi i politikës kombëtare
- Miratimi i akteve ligjore
- Kompetenca ekzekutive

Funksioni dhe të drejtat gjatë simulimit:

- Këshillim për kërkesat për anëtarësim
- Përcaktim i kuadrit politik drejtues për procesin e zgjerimit
- Marrja e vendimit rreth hapjes së bisedimeve të anëtarësimit
- Ngarkimi i Komisionit me drejtimin e bisedimeve
- Marrje e vendimit unanim rreth anëtarësimit të kandidatëve

M 20. Procedura e anëtarësimit në Lojën Plan

Pjesa I. Aplikimi



Pjesa II: Bisedimet për anëtarësim

